5951/1
14.07.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

PROJEKT-VENDIM

NR. 63 DATË 14/07/2025

"MBI DHËNIEN E SHPËRBLIMIT SPORTISTES AMANDA DEDEJ, FITUESE E MEDALJES SË ARTË NË LIGËN BOTËRORE TË KARATESË"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/____/2025, pasi analizoi relacionin paraqitur nga Kryetarja e Bashkisë "*Mbi dhënien e shpërblimit sportistes Amanda Dedej, fituese e medaljes së Artë në Ligën Botërore të Karatesë"* si dhe mbeshtetur ne ligjin nr. 139/2015 *"Për vetëqeverisjen vendore"*, neni 54 shkronja"n" dhe ligji 68/2017"Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore|",neni 6 shkronja "a",neni 7 pika 2, si dhe VKM nr 789 datë 15.12.2021 "Për Kriteret, Mënyrën e Shpërblimit dhe Trajtimin e Sportistëve, që Përfitojnë Statusin e Nivelit të Lartë dhe trajnerëve të tyre,pika 16;

PROPOZOJMË:

1. Të miratojë shpërblimin me vlerë prej **100 000** ***(njëqind mijë)*** lekë për sportisten Amanda Dedej.
2. Në Aparatin e Bashkisë do të pakësohet Fondi Rezervë *(*programi AF 129) në vlerën 100,000 *(njëqind mijë)* lekë dhe të shtohen shpenzimet operative në programin menaxhimi dhe shërbimet mbështetese (program AA129-602-01) për 100,000 *(njëqind mijë)* lekë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financë-Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ***(dhjetë)*** ditë pas shpalljes.

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

KRYETAR I BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

Nr. 5951 Prot. Lushnje më, 14/07/2025

R E L A C I O N

KESHILLIT BASHKIAK

"MBI DHËNIEN E SHPËRBLIMIT SPORTISTES AMANDA DEDEJ, FITUESE E MEDALJES SË ARTË NË LIGËN BOTËRORE TË KARATESË"

Të nderuar zoterinj këshilltarë!

Bashkia Lushnje, nëpërmjet këtij relacioni, paraqet për miratim propozimin për dhënien e një shpërblimi financiar për sportisten Amanda Dedej, e cila ka përfaqësuar denjësisht qytetin e Lushnjës dhe Shqipërinë në arenën ndërkombëtare. Amanda ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm në sportin e karatesë, duke fituar medaljen e artë në Ligën Botërore të Karatesë, e zhvilluar në Kroaci. Ky është një shembull i qartë i përkushtimit, disiplinës dhe punës së saj të palodhur.

Ekipi kombëtar i të rinjve në karate mori pjesë në Ligën Botërore në Kroaci, ku karateistja 14-vjeçare Amanda Dedej fitoi medaljen e artë në peshën deri në 52 kg. Në këtë garë botërore morën pjesë 4000 sportistë nga 78 vende të ndryshme të botës. Amanda Dedej, sportiste me origjinë nga Lushnja, ka arritur sukses në arenën ndërkombëtare. Ky rezultat është një arritje me rëndësi të veçantë për sportin shqiptar dhe për komunitetin lushnjar, duke u përfaqësuar me dinjitet në një kompeticion të nivelit të lartë botëror në fushën e karatesë

Arritja e saj është vlerë e madhe jo vetëm për komunitetin sportiv, por për të gjithë qytetarët lushnjarë dhe përbën shembull frymëzimi për të rinjtë tanë. Në vlerësim të kontributit dhe suksesit të saj, si dhe për të nxitur dhe promovuar sportet dhe të rinjtë,propozohet që Këshilli Bashkiak i Lushnjës të miratojë dhënien e një shpërblimi financiar në vlerën prej **100,000** ***(njëqind mijë)*** lekë për sportisten Amanda Dedej.

Kjo mbështetje financiare do të jepet nga fondi rezervë në buxhetin e Bashkisë Lushnje.Propozojmë miratimin e projekt-vendimit bashkalidhur.

Ju faleminderit!

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com